



In medias res

Vizioni kurrikular një ëndërr që shoqëria , nxënësit dhe mësimit duhet ta përjetojnë në zhgënjendërr

Ç'mund të ishte më e keqe se verbëria e trashëguar? "[...] të kesh sy e të mos kesh vizion"
Helen Keller

Helen Keller ka qenë e verbër. Diku në moshën shtatëdhjetëvjeçare ka arritur të doktorojë në psikologji. Në SHBA, është një institut që mbanë emrin e saj i cili përkujdeset për ata persona që kanë pengesa në zhvillim. Ka qenë shkencëtare dhe humaniste, me ëndrrën e vetë edhe pse e verbër ka arritur ta bëjë realitet

Ëndrrën që të bëhet shkencëtare në fushën e psikologjis në mënyrë që të jetë në gjendje t'u ndihmojë njerëzve që kanë pengesa dhe vështirësi në zhvillim. Me këtë vizion është udhëhequr gjatë gjithë jetës dhe më në fund ka arritur këtë ta bëjë realitet. Kjo ka arritur, fal vizionit të saj që ëndrrën saj ta bëjë zhgënjendërr.

Vizioni është ajo forcë që njerëzve u jep krahë të "fluturojnë" dhe të arrijnë atje ku ata ëndërrojnë . Vizioni është forca e cila të pamundurën e bënë të mundur.

Edhe në Kosovë, gjatë zhvillimit të projekteve të shumta nga KEC, kemi gjetur shumë shembuj të fëmijëve me vizion, të cilit kanë arritur që pengesat të trashëguar të shndërrojnë në përparësi dhe t'ua kalojnë edhe atyre që nga nëna natyre nuk janë dëmtuar. Këtë e dëshmon më së miri shembulli i fëmijët nga komuna e Malishevës të cilit i mungojnë të dy duart. Këtë hendikep, fal forcës dhe energjisë që është fshehur pas vizionit të pamundurën e bënë të mundur. Këtë e dëshmon edhe kjo fotografi.



Foto: 1. Ky fëmijë është nxënës në një shkollë të Malishevës. Nuk ka duar. Forca e vizionit të pamundururën e bënë të mundur

Kornizat kurrikulare, kurrikulat shkollor, kurrikulat lëndor, mësimit dhe udhëheqësi pa vizion janë objekte që nuk kanë shpirt, nuk kanë forcë dhe energji andaj bredhin lartë poshtë, janë të dështuar. Duke qenë të vetëdijshëm për rolin e vizionit si përbërësi kryesor kurrikular në vazhdim do të shkruaj për konceptin e tij, do të prezantojë shembuj të vizioneve të vendeve të ndryshme, në mënyrë që mësimit dhe ekspertë arsimor në Kosovë kësaj teme t'i përjasen me seriozitet më të madh.

Shkroi: Halim Hyseni

Programi i granteve për zhvillimin e shkollave

■ Nga 1-14 shkurt 2011 janë mbajtur takimet e Ekipeve Komunale për Grante Shkollore (EKGSh) në të gjitha komunat e Kosovës. Këto ekipe kanë vlerësuar projektet e 114 shkollave të përzgjedhura në rundin e parë në kuadër të projektit GZhSh dhe kanë aprovuar të gjitha ato. Me 21 shkurt 2011 është mbajtur takimi i Komisionit për Aprovimin e Granteve Shkollore (KAGSh), i cili ka aprovuar projektet e 110 shkollave, ndërsa ka rekomanduar 4 shkolla të bëjnë ndryshime në projektet e tyre në pajtim me kriteret e përcaktuara në manualin e GZhSh. Këto shkolla do të rishikojnë edhe njëherë projektet e tyre dhe pas përgatitjes së projekteve të reja do të përcjellin të gjitha procedurat për aprovim.

■ Pjesë e rëndësishme e projektit të GZhSh është ndërtimi i kapaciteteve të DKA-ve për të monitoruar implementimin e projekteve shkollore. Për këtë qëllim, KEC ka përgatitur kornizën e monitorimit, e cila do të përdoret nga përfaqësuesit e DKA-ve dhe bashkëpunëtorët profesional të terrenit me rastin e monitorimit të zbatimit të projekteve nga shkollat përfituese. Prezantimi i kësaj kornize për përfaqësuesit e DKA të rajoneve të Pejës, Gjakovës dhe Prizrenit është bërë më datën 25 shkurt në Qendrën Didaktike në Gjakovë, ndërsa e njëjta do të organizohet me 2 mars në Prishtinë për përfaqësuesit e DKA të rajoneve: Prishtinë, Mitrovicë, Ferizaj dhe Gjilan.

KOSOVISION Contest

■ Gjatë këtij muaji janë bërë planifikimet e projekteve të klasave fituese me qëllim që të vetëdijesohen dhe të vazhdojnë me fazën e dytë të projektit. Në fillim të muajit shkurt, në të gjitha regjionet e Kosovës janë mbajtur trajnimet njëditore ku mësimdhënësit e klasave fituese janë pajisur me materialet e punës për fazën e dytë.

Po ashtu, është kërkuar që mësimdhënësit për dy javë rresht të punojnë në mbledhjen e dokumentacionit përkatës, plotësimin e formularëve të projekt ideve dhe në këtë mënyrë është bërë edhe intervista me ta ku janë nënshkruar të gjitha kontratat me mësimdhënësit për vazhdimin e punës.

■ Kanë përfunduar të gjitha përgatitjet e ekskursionit i cili do të realizohet në fillim të muajit mars me klasat fituese të shortit i cili u tërhoq gjatë ceremonisë kryesore.

Promovimi i të drejtave të fëmijës në fushën e arsimit

■ Në kuadër të projektit "Promovimi i të drejtave të fëmijës në fushën e edukimit", financuar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë, gjatë këtij muaji janë zhvilluar këto aktivitete:

- Raporti vjetor për vitin e dytë i është dërguar Komisionit Evropian.

- Janë duke u bërë përgatitjet për zhvillimin e monitorimit të katërt. Deri më tani janë përgatitur pyetësorët dhe materialet tjera përcjellëse për hulumtuesit. Gjatë muajit mars do të filloj shpërndarja e pyetësorëve nëpër shkolla.

- Këtë muaj, janë bërë përgatitjet e për grantet e vogla shkollore, të cilat do të përdoren nga shkollat për realizimin e aktiviteteve të ndryshme që kanë të bëjë me të drejtat e njeriut-fëmijës. Takimet me këshilltarët për të drejtat e fëmijës dhe komitetet shkollore do të mbahen në fillim

të muajit mars, me ç'rast ata do të njoftohen me procedurat e përgatitjes së projekt propozimeve dhe aplikimit.

Avancimi i pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grupeve të pakicave etnike në arsim

■ Në kuadër të komponentës 4 të Projektit, Iniciativat Lokale, në të gjitha shtetet pjesëmarrëse në projekt janë vizituar shkollat dhe janë ndihmuar në realizimin e projekteve të tyre. Në Kosovë është mbajtur një punëtori një ditore gjatë së cilës përfaqësuesit e shkollave janë përgatitur për të mbajtur seanca me kolegët e tyre në shkolla. Pas punëtorisë përfaqësuesit e shkollave kanë mbajtur nga tre seanca me kolegët e tyre.

• Gjatë prillit do të mbahet konferenca përfundimtare e projektit ku do të marrin pjesë 70 pjesëmarrës nga vendet partnere në projekt. Konferenca do të mbahet në Shqipëri dhe do të jetë një rast i mirë për tu prezantuar rezultatet e projektit Avancimi i Pjesëmarrjes dhe Përfaqësimit të Grupeve Pakicë në Arsim.

Pjesëmarrja e prindërve në vendim marrje në shkollë

■ Me datën 3 shkurt u organizua një tryezë e rrumbullakët ku u paraqitën dhe u diskutuan tre politikat e hartuara nga një grup i prindërve nga 6 komunat e përfshira në projekt. Politikat e prezantuara ishin:

1. Rritja e kohëzgjatjes së qëndrimit të nxënësve në shkollë.
2. Roli i prindërve në vendimmarrje në shkolla.
3. Siguria e nxënësve në shkolla.

Këto politika pas përpunimit të komenteve dhe sugjerimeve të dala nga kjo tryezë do t'i dorëzohen MASHT-it dhe Këshillave të prindërve nëpër komuna

dhe me këtë aktivitet projekti "Vendimmarrja e prindërve në arsim" përfundon.

Hap pas Hapi

■ Në Ferizaj me datat 5,6 dhe 13 u organizua trajnimi për mësuesit e klasës së katërt. Në këtë grup ishin të përfshirë edhe mësues nga Gjilani dhe Prizreni. Për tu certifikuar pjesëmarrësit prezantuan planet mujore me datën 26 shkurt.

Parandalimi i dhunës në shkolla

■ Gjatë këtij muaji në kuadër të këtij projekti janë zhvilluar këto aktivitete:

- Është bërë prezantimi publik i projektit në Hotelin Grand në Prishtinë ku kanë marrë pjesë 46 veta.
- Është bërë promovimi i librit: "Parandalimi i dhunës në shkolla"
- Është mbajtur një punëtori gjysmëditore me anëtarë të Komiteteve të formuara rajonale dhe komunale për Mbrojtjen e të Drejtave të fëmijës
- Është hartuar Korniza për Monitorimin dhe zbatimin e projektit
- Është bërë prezantimi i Kornizës së Metodologjisë për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të Projektit
- Janë hartuar draft- instrumentet për monitorim dhe vlerësim, sondazhi i të cilëve do të bëhet gjatë këtij muaj

Janë përpiluar: Termet e referencës për mbështetjen financiare të Rrjetit Mbrojtës të Mjediseve të Sigurta

Është hartuar plani për Monitorimin final të 168 shkollave pilot në pesë komuna

Qasja Tërësektoriale në Arsim – EU EDUCATION SWAp

■ Projekti Qasja Tërësektoriale në Arsim - EU EDUCATION SWAp ka filluar të implementohet në muajin tetor të vitit të kaluar. Ky projekt financohet nga Komisioni Evropian dhe menaxhohet nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë (ECLO).

Projekti implementohet nga konsorciumi i përbërë nga Cambridge Education, Qendra për Arsim e Kosovës, Education 2000+ Consulting dhe Tribal Helm.

■ Me datën 15-16 shkurt është mbajtur një punëtori më përfaqësuesit e DKA-ve me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të strukturave komunale të arsimit

■ Është finalizuar dhe dërguar Raporti i Progresit për periudhën shtator-dhjetor 2010.

një afati të caktuar të gjitha qendrat të pajisen me këtë inventar.

■ Gjithashtu gjatë këtij muaji është mbajtur edhe mbledhja e komisionit për vlerësimin e ofertave për pajisjet teknologjike (IT). Edhe pse është bërë një përzgjedhje provizore e ofertës më të favorshme, nga ofertuesit nevojiten edhe disa dokumente shtese që tregojnë origjinën e pajisjeve konform standardeve evropiane.

Përgatiti: Petrit Tahiri

Mbështetje e BE-së për Zbatimin e Strategjisë për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptas (EU-SIMRAES)

■ Në kuadër të projektit “Mbështetje e BE-së për Zbatimin e Strategjisë për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptas”, financuar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë, gjatë këtij muaji janë zhvilluar këto aktivitete:

■ Është organizuar trajnimi 3 ditor me përfaqësuesit e qendrave. Janë caktuar fasilitatorët dhe tutorët që do të punojnë në qendra.

■ Janë shqyrtuar ofertat për furnizim të qendrave me pajisje inventari. Nga komisioni është përcaktuar edhe oferta më e favorshme. Pritet që brenda